



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës



Raport i Punës për tremujorin e dytë

Prill-Qershor, 2025

Prishtinë, Korrik 2025

Ky raport paraqet punën e OMK-së për periudhën Prill-Qershor të vitit 2025.

Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të OMK-së, duke u koncentruar në fushat kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së Odës.

Përmbajtja:

1. Këshilli Drejtues	4
2. Këshilli Mbikqyrës	4
3. Anëtarësimi.....	5
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	6
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.....	6
6. Licencimet.....	7
7. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	8
8. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke	8
9. Raporti financiar	8
<i>9.1 . Raporti financiar për periudhën Prill - Qershor 2025</i>	<i>8</i>
10. Aktivitete të tjera.....	9
10.1 Revsita Mjeku- 100 Vjet për Shëndet.....	9
10.2 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	10
11. Plani i veprimit për 2025.....	11

1. Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tre takime, lëndët e shqyrtuara janë si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill - qershor	Vendime/ Përgjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Vendimet/ Përgjigjet sipas kërkesave/ an kesave të pranuar për periudhën prill - qershor	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën prill - qershor
Këshilli Drejtues	13	0	11	2	- Vendimi për aprovim të Pasqyrave Financiare dhe Raportit të Auditimit për vitin 2024;

Vendimet në procedurë janë për faktin se janë pranuar pas mbajtjes së mbledhjes së fundit të Këshillit Drejtues në muajin Qershor dhe pritet të shqyrtohen në mbledhjen e parë të muajit Korrik 2025.


2. Këshilli Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës i Odës së Mjekëve të Kosovës ka zhvilluar katër takime, ku i kanë shqyrtuar Raportin për tremujorin e parë të punës së OMK-së, Raportin financiar për periudhën tre mujore janar-mars 2025, Vendimet e Këshillit Drejtues si dhe të organeve të tjera të OMK-së.


Brenda kësaj periudhe është adresuar edhe një kërkesë zyrtare, për të cilën Këshilli ka hartuar dhe përcjellë një rekomandim përkatës, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë që i takojnë këtij organi mbikqyrës.

3. Anëtarësimi

Në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 90 mjekë, 9 mjekë të punësuar në sektorin privat, 14 mjekë të punësuar në sektorin publik dhe 67 mjekë të papunë.



Grafikoni 1: Anëtarësime për periudhën kohore Prill – Qershor 2025



Grafikoni 2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 30 Qershor 2025

Gjatë kësaj periudhe janë rianëtarësuar 8 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 30 Qershor është 5627 mjekë.

4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale, Prokurorit të odës, Gjyqit të Nderit dhe certifikatat e te kaluares etike dhe profesionale, do të paraqesim në mënyrë tabelare.


ORGANI	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM2	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM2	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM2	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM2	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	36	13	24	N/A	N/A	25
Këshilli Etik	34	12	28	Rekomandim kolegjale 6 Qortim Publik 4 Gjobe 3	Rekomandim kolegjale 1	18
Gjyqi i Nderit	0	2	1	///	///	1
Certifikatat e kaluarës etike	///	165	///	///	///	///

Gjatë këtij tre mujori janë lëshuar 165 certifikata për të kaluarën etike dhe profesionale. 133 certifikata janë lëshuar për mjekët që kanë marrë certifikata për shtesa mbi pagë në sektorin publik Rregullorja nr. 02/2023, dhe mjekët që kanë marr certifikata edhe viteve të kaluara. Ndërsa 32 certifikata janë lëshuar për mjekët që janë paisur me certifikata për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional


Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional ka akredituar gjithsej 39 aktivitete, prej të cilave 2 aktivitete janë ligjërata vjetore si dhe është marrë vendim për anulimin e një certifikate të akreditimit, pas verifikimit të rrethanave dhe në përputhje me rregulloren përkatëse.

Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, prej këtyre akreditimeve 10 aplikime janë me taksë administrative.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë kësaj periudhe, ka lëshuar gjithësej 274 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



7. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar gjithsejt 51 kërkesa për leje-hulumtim dhe ka pranuar gjithsejt 15 kërkesa për raport përmbyllës. KÇE për 51 kërkesa të shqyrtuara ka nxjerr 44 Vendime aprovuese, dhe 3 Vendime refuzuese, rrjedhimisht janë të bartura 4 lënd për tu shqyrtuar. KÇE për 15 raporte përmbyllëse të shqyrtuara ka nxjerr 14 Vendime aprovuse. Rrjedhimisht është bartur një raport përmbyllës në periudhen vijuese.

8. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar gjithsej tri kërkesa për përkrahje financiare. Nga këto, komisioni ka aprovuar një kërkesë, ka refuzuar një kërkesë, ndërsa një kërkesë është bartur për shqyrtim në periudhën e ardhshme.

Po ashtu, komisioni ka pranuar tre kërkesa për përkrahje lidhur me shpenzimet e varrimit dhe ka marrë vendime për aprovimin e të tri kërkesave.

9. Raporti financiar

9.1. Raporti financiar për periudhën Prill - Qershor 2025

RAPORTI FINANCIAR DERI ME 30 QERSHOR 2025			
1.0 Të hyrat:			
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2024	€	843,465	
Total Paraja në bankë me 31.12.2024			€ 843,465
1.2 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	TOTAL
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:			
1.2.1.1 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 342,715	€ 154,559	€ 497,274
1.2.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 1,800	€ 3,100.00	€ 4,900
1.2.2 Licencimi	€ 13,647	€ 12,700	€ 26,347
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€ 11,709	€ 12,986	€ 24,695
Të hyrat deri me 30.06.2025	€ 369,871	€ 183,345	€ 553,216
TOTAL TË HYRAT			€ 1,396,681

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	TOTAL
2.1 Paga, meditje dhe kontributet pensionale	€ 84,791	€ 66,799	€ 151,590
2.2 Material shpenzues	€ 518	€ 1,694	€ 2,211
2.3 Reprezentacioni	€ 846	€ 756	€ 1,602
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 52,796	€ 8,480	€ 61,276
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 7,598	€ 10,638	€ 18,236
2.6 Shpenzimet e aseteve			€ -
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 8,450	€ 5,150	€ 13,600
2.8 Llogari të Pagushme (Obligim i bartur-Meditje dhe tatime)		€ 7,976	€ 7,976
TOTAL SHPENZIMET 30.06.2025	€ 154,999	€ 101,492	€ 256,492
Neto të hyrat për TM2 2025			€ 296,725
TOTAL BILANCI 30.06.2025			€ 1,140,190

1.2.3.* Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit, Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat të tjera.

2.5* Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Organizimi i mbledhjeve të kuvendit, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Meditje për udhëtime zyrtare, Mirembajtja e softverit për financa, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzimet e tjera operative

10. Aktivitete të tjera

10.1 Revsita Mjeku- 100 Vjet për Shëndet

Vëllimi 5, Numër 2, “100 Vjet për Shëndet”, artikujt në këtë janë të përgaditur kryesisht nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë për nder të 100 vjetorit të themelimit të institucionit, si një kontribut profesional dhe shkencor për shëndetin publik në Kosovë. Ky numër është publikuar gjatë muajit Qershor 2025 dhe përbëhet gjithsej prej 31 artikujve të përmbledhur në 92 faqe.

Revista është publikuar në faqen zyrtare të facebookut dhe Ëeb-faqen e OMK-së

Të bashkëngjitur mëposhtë gjeni linkun e publikimit të këtij numri:

[Revista Mjeku - 100 Vjet për Shëndet](#)

10.2 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill - qershor	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën prill - qershor	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën prill - qershor	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	5	1	0	0	0

Në këtë periudhë kohore katër lëndët e pranuar nga Gjykatat dhe Prokuroritë janë kthyer prapa me arsyetimin sepse nuk është duke u ekzekutuar asnjë pagesa e ekspertëve të caktuar nga Oda e Mjekëve dhe një kërkesë është nga Prokurori i Odës që vendimi për themelim të Komisionit është bërë në muajin korrik 2025.

11. Plani i veprimit për 2025

- Vazhdimi i realizimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për sektorin e shëndetësisë” dhe OPSH-të. Në këtë fazë sipas procedurave administrative dhe hapave të planifikuara deri në përfundim të projektit, kemi pranuar lejen për kushtet ndërtimore nga komuna e Prishtinës, është bërë plani detal i objektit nga arkitektët dhe gjithahtu OPSH-të së bashku me projektin Luxembourg Development kanë filluar procedurat e prokurimit për fillimin e punimeve. Hapi i ardhshëm i projektit është përfundimi i procedurave të prokurimit të përzgjedhjes së operatorit ekonomik për ndërtimin e objektit të përbashkët për OPSH-të si dhe pas procedurave administrative fillimi i punime për ndërtim.
- Organizimi i Kongresit të VII të Mjekësisë.
Më 28 mars 2025, me vendim të Kryetarit të Odës së Mjekëve të Kosovës, është themeluar Këshilli Shkencor dhe Organizativ i Kongresit të VII-të me radhë, i cili do të organizohet nga OMK. Tema kryesore e Kongresit është: **“Emergjenca, Kujdesi Intensiv dhe Anestezioni në Kriza Mjekësore: Sfidat e sëArdhmes”**, ndërsa datat e mbajtjes janë përcaktuar për 21–23 nëntor 2025. Regjistrimi i pjesëmarrësve pasiv është mbyllur brenda një afati rekord prej 72 orësh, duke dëshmuar interesim të jashtëzakonshëm. Brenda kësaj periudhe kanë aplikuar 2000 pjesëmarrës, gjë që tregon për rëndësinë dhe besueshmërinë që komuniteti mjekësor i atribuon këtij Kongresi. Në këtë ngjarje shkencore pritet të marrin pjesë 50 ligjërues nga rajoni dhe Evropa, përfshirë ligjërues të specializuar për Ëorkshop-e praktike, që do të zhvillohen në kuadër të programit të Kongresit.
- Botimi i numrave në vazhdimësi të “Revistës Mjeku”.
- Vazhdimi i zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit, bazuar në marrëveshjen mes OMK-së dhe SHSKUK.
- Organizimi i zgjedhjeve për legjislaturën e IV-të të OMK-së.